



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 62/12
Prishtinë, më 02.05.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Ardita Fejza (praktikante), Kushtrim Aliu (praktikant), Dafina Krasniqi (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Mrika Tahiri, Naim Avdiu, Avni Jashari nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit, Dritan Gjonbalaj, Ylber Aliu, Shqipe Krasniqi–Selishta nga Autoritetit të Aviacionit Civil Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur të komisionit më 18.04.2012, dhe 25.04.2012;**
3. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2011;**
4. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2011;**
5. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2011;**
6. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Zyrës Rregullative të Energjisë për vitin 2011;**
7. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-95 për Diasporën e Kosovës me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
8. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-67 për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
9. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimitisht.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur të komisionit më 18.04.2012, dhe 25.04.2012

Kryetarja, konstatoi se procesverbalet e nga mbledhjet e mbajtur të komisionit më 18.04.2012, dhe 25.04.2012, u miratuan njëzëri.

3. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2011

Kryetarja, theksoi raporti i AKP-së në siç e kërkon ligji, është proceduar për miratim në Kuvend, dhe nga raporti shifet se buxheti i shpenzuar i AKP-së për vitin 2011, është 96%. Shifet që ka përkrahje nga donatorët sidomos për pozicionin Paga dhe Mëditje. Fjalën e kanë përfaqësuesit e AKP-së për sqarim më të detalizuar.

Mrika Tahiri, theksoi se siç e kërkon ligji i AKP-së kemi paraqitur të gjitha pasqyrat financiare të llogarive të agjencisë, gjithashtu kemi paraqitur një raport të shkurtër lidhur me punën e agjencisë, sukseset dhe sfidat të cilat përballemi.

Avni Jashari, AKP ka paraqitur dy palë pasqyra financiare. Sipas nenit 20, paragrafi 1, janë paraqitur pasqyrat financiare për buxhetin e Kosovës, të hyrat e dedikuara nga donatorët dhe sipas paragrafit 2 janë paraqitur pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesimit. Të gjitha pasqyrat janë në përputhje me ligjin e Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Udhëzimet Administrative të Ministrisë së Financave si dhe sa i përket Fondeve në Mirëbesim në pajtim me Kornizën Raportuese. Janë paraqitur tabelat të cilat parashihen me Udhëzuesit e Ministrisë së Financave si dhe Rrjedhën e Parasë të paraqitur në Bankën Qendrore të Kosovës. Në fund të vitit në llogarinë Bankare në Mirëbesim AKP ka pasur 585 milion e 762 mijë euro, ndërsa gjendja momentale ka kaluar në 6 milion.

Hykmete Bajrami, pyetjet lidhen me fondin e mirëbesimit, pagesat e 20 %-shit janë çështje delikate dhe për të bërë pyetje për fondin e mirëbesimit duhet studiuar mirë atë lëmi mirëpo sa i përket pasqyrave të raportit të përgjithshëm veçmas tek donatorët mendoj që është një raport shumë narrativ, nevojitet një kategorizim më i detalizuar sepse kështu kemi punuar me të gjitha agjencionet e pavarura, kemi kërkuar raporte të detalizuara. Ne jemi të hendikepuar sepse nuk kemi raport të auditorit, raporti juaj është në fokus të një komisioni tjetër që është komision funksional.

Kryetarja, sqaroi se në faqen 10 të raportit janë paraqitur në mënyrë të detalizuar të gjitha nënkategoritë e mallrave dhe shërbimeve dhe njëkohësisht janë të paraqitura edhe të planifikuara. Dua të them që prej se ka kaluar në duar të vendorëve të paktën raportet nga AKP kanë ardhur të detalizuara me mjaft shënime për të bërë analiza.

Sali Asllanaj, theksoi se nuk e kam të qartë përdorimin e termit Buxheti i Rishikuar mund të përdoret Buxhet i Përfunduar, por jo i Rishikuar.

Kryetarja, e kemi të qartë që nuk mund të përdoret termi Buxhet i Rishikuar sepse Buxheti rishikohet në fund të qershorit dhe kalon përmes Kuvendit. Fjala rishikim nënkupton rishikimin që bëhet pas 6 muajsh.

Avni Jashari, janë formularët standard të sjellur nga Ministria e Financave dhe asnjë Organizatë Buxhetore nuk ka leje të ndryshoj formularët nga Ministria. Kolona e 2-të paraqitet si e tillë Rishikimi Buxhetor pa marrë parasysh a kemi pasur apo jo rishikim.

Hykmete Bajrami, tek faqja 10 shpenzimet e kategorizuara i kemi disa psh departamenti i auditimit, likuidimi a janë fonde që ndahen nga Fondi i Mirëbesimit? Dhe me sa kuptoj unë për shembull likuidimi kryhet nga fondet e privatizimit që është Fond i Mirëbesimit, dmth janë shpenzuar në fazë likuidimi. Faza e tranzicionit 559 mijë euro ndërsa faza e likuidimit 232 mijë euro. A janë këto fonde që merren nga Fondi i Mirëbesimit?

Avni Jashari, në pasqyrat financiare në faqen 10 tek pjesa buxhetore e likuidimit i kemi paraqitur dy ndarje. Një është faza e tranzicionit e cila përfundon në momentin kur vendosë një ndërmarrje shoqërore të shkoj në likuidim dhe tjetra është faza e likuidimit që fillon një ndërmarrje shoqërore të shkoj në likuidim. Kjo pjesë e parave 232 mijë euro që është shpenzuar shfrytëzohet për ato ndërmarrje shoqërore të cilat ende nuk kanë fonde në llogaritë bankare të likuidimit dhe kompensohet në momentin që gjenerohen të hyrat e mjaftueshme nga shitjet apo nga procesi i likuidimit. Gjatë viteve paraprake i kemi kthyer buxhetit të Kosovës rreth 634 mijë euro dhe besojmë që deri muajin qershor të kthehet edhe pjesa e mbetur. Këto shpalosje i kemi bërë edhe gjatë paraqitjes së buxhetit të viti 2011, ku me rastin e përpilimit të buxhetit paraqesim edhe cilat kategori kompenzohen më vonë dhe i kthehen buxhetit të Kosovës.

Pas diskutimeve, Komisionit me gjashtë vota Pro (Safete Hadërgjonaj, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe Albana Fetoshi), dy Abstenime (Hykmete Bajrami dhe Sali Asllanaj) dhe asnjë kundër nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit miratimin e Raporti Financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2011

4. Shqyrtimi i Raportit Financiar i Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2011

Kryetarja, raporti financiar i AAC-së përfshin pasqyrat financiare mbi aktivitetet për periudhën 1 janar 31 dhjetor 2011. Duke u bazuar në nenin 15.2 të ligjit për Aviacionin Civil, AAC është i obliguar të që t'i sjell këto të dhëna: pika (i) Niveli i rrogave të AAC, pika (ii) prokurimet, menaxhimin financiar dhe çështjet buxhetore. Këtu kemi të bashkangjitur edhe raportin financiar. Sot AAC ka sjellur edhe Raportin Vjetor për Kontratat e Nënshkruara Publike apo raportin e prokurimit.

Dritan Gjonbalaj, AAC ka 21 punëtorë dhe 2 bashkëpunëtorë, përveç shoferit tërë personeli i AAC-së ka ngritje universitare, personeli teknik ka diploma universitare në fusha të ndryshme të Aviacionit Civil. Kemi edhe pilot që nevojiten për të bërë mbikëqyrje sa më të mirë të sigurisë së Aviacionit Civil në Kosovë. AAC vetë financohet nga të hyrat siq përcaktohet në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Të hyrat e AAC-së janë nga dy burime: tarifa e sigurisë së pasagjerëve nga 2 euro për secilin pasagjer që niset nga Aeroporti i Prishtinës për shkak të aktiviteteve rregullatore që i kryen AAC-ja për të garantuar sigurinë e fluturimeve të tyre që është Rregullorja për Tarifat e Licencimit dhe Certifikimit cila ka hyrë në fuqi vitin e kaluar dhe u është shuar të hyrave të dedikuara të AAC-së. Ligji i AAC-së rregullon edhe mënyrën e miratimit të nivelit të rrogave të AAC-së, është një skemë rrogash e miratuar nga Ministri i Financave. Fillon nga 350 euro që e ka shoferi i logjistikës deri në 1.903 euro sa është rroga e drejtorit të përgjithshëm të AAC-së. Çështjet e buxhetit, financave dhe prokurimit i kemi përmbledhur në një doracak të procedurave të AAC-së dhe besojmë se këto procedura zbatohen në mënyrë të përpiktë nga personeli

përgjegjës për këtë fushëveprim. AAC ende nuk ka arritur të vendoset në një objekt shtetëror, vazhdojmë të operojmë në objekt me qira. Në fund të viti të kaluar kemi ndërruar objektin dhe shuma e qirasë mujore që e paguajmë tash është 50% më e ulët se vitin e kaluar, 3.300 euro në muaj. Të hyrat totale gjatë 2011 kanë qenë 1 milion e 284 mijë euro, alokimi i buxhetit 750 mijë euro dhe pas shkurtimeve buxheti përfundimtarë ka qenë 728 mijë e 821 euro. Kemi vazhduar trajnimin e personelit prej të hyrave tona, kemi pasur edhe donacione nga Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit që kompetenca e personelit të jetë në nivel të njëjtë me ato të vendeve të BE-së.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit miratimin e Raporti Financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2011.

5. Shqyrtimi i Raportit financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2011

Kryetarja, theksoi se Agjencia Kosovare e Pronës sipas kërkesë së Komisionit në mbledhjen e fundit, ka sjellur raportin financiar me të dhënat e detalizuara, ku janë përfshirë informacionet e kërkuara.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit miratimin e Raporti Financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2011.

6. Shqyrtimi i Raportit financiar të Zyrës Rregullative të Energjisë për vitin 2011

Kryetarja, njoftoi se ZRRE, sipas kërkesës së Komisionit, ka sjellur raportin plotësues financiar, ku janë pasqyruar të dhënat shtesë lidhur me planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit dhe specifikimin në kategoritë dhe nënkategoritë e caktuara.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit miratimin e Raporti Financiar të Zyrë Rregullative të Energjisë për vitin 2011.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-95 për Diasporën e Kosovës me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryetarja, theksoi se projektligji nuk përmban implikime direkte buxhetore dhe çdo ndikimin negativ buxhetor do të kufizohet me nenin 14 ku thuhet: Institucionet e ndikuara me këtë ligj, sipas mundësive buxhetore të lejuara me Ligjin Vjetor të Buxhetit i përmbushin obligimet e tyre. Po ashtu edhe amandamentet e Komisionit Funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni, njëzëri nxorri këtë

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-67 për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetarja, njoftoi se në mbledhjen e komisionit të mbajtur më 09.12.2011 pas shqyrtimit të këtij projektligji ka vlerësuar se disa dispozitat e këtij projektligji përmbajnë implikime buxhetore, dhe kemi rekomanduar që të mbajmë një takim të përbashkët me komisioni funksional. Takimi është mbajtur më 07.02.2012 dhe në atë takim ne kemi propozuar disa amendamente si komision dhe nga raporti i komisionit funksional, shifet se propozimet tona janë përfshirë në amendamentet këtij komisioni, kështu mund të rekomandojmë që projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni njëzëri nxorri këtë

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

9. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi: 11:50

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj